

NJOFTIME FITUESI PËR PROCEDURA TË KUFIZUARA

BASHKIA TIRANË FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Drejtuar: Operatorit ekonomik "A.SH. Engineering" shpk
Adresa: Njesia Bashkiake Nr 7, Rruga "Vllazen Manastirliu", Pallati 11, Kati 2, Apartamenti 5, Tirane;

Procedura e prokurimit: Kolaudimi i punimeve për objektin: "Ndërtimi i rrugëve të brendshme në RSU 3".

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-14453-12-07-2021

Përshkrim i shkurtër i kontratës: "Tender i Kufizuar" me Marrëveshje Kuadër në kuadër të procesit të rindërtimit, e perzgjedhur në mbështetje të Nën mbështetje të Aktit Normativ Nr.9, datë 16.12.2019 "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", Udhëzimit Nr.1, datë 13.02.2020 të Agjencisë së Prokurimit Publik, pika 7.1, Ligjit Nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik", Neni 52, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285 datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", Kreu V, seksioni 2 Neni 35, Neni 74 është "Tender i Kufizuar", (në kuadër të procesit të rindërtimit)".

Publikime të mëparshme: Nuk ka

Lista e operatorëve ekonomikë të kualifikuar në përfundim të fazës së parë të procedurës së sipërcituar: Sipas short-listing të pasqyruar në Sistemin e Prokurimit Elektronik.

1. Operatori ekonomik "A&E Engineering" shpk NUIS K72113010E
2. Operatori ekonomik "A.SH. Engineering" shpk NUIS L31617003F
3. Operatori ekonomik "INFRATECH" shpk; NUIS K91628001D
4. Bashkimi i operatorëve ekonomikë "STATENG" shpk & "HE&SK 11" shpk
NUIS L98819501J & NUIS L19008502B
5. Bashkimi i operatorëve ekonomikë "TESLA VIZION" shpk & "NET-GROUP" shpk
NUIS L31518001O & NUIS L72023002P
6. Bashkimi i operatorëve ekonomikë "DEA-N CONSULTING STUDIO" shpk & "M.A.K Studio" shpk" shpk
NUIS L11511002I & NUIS L01422017O

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në fazen tjetër të procedurës së sipërcituar këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik "A.SH. Engineering" shpk NUIS L31617003F
Oferta ekonomike = 39,200 (tridhjetë e nëntë mijë e dyqind) lekë pa TVSH.

2. Operatori ekonomik “A & E ENGINEERING” shpk NUIS K72113010E
Oferta ekonomike = 155,500 (njqind e pesedhjetë e pese mijë e peseqind) lekë pa TVSH.

3. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “TESLA VIZION” shpk & “NET-GROUP” shpk
NUIS L31518001O L72023002P
Oferta ekonomike = 47,000 (dyzet e shtatë mijë) lekë pa TVSH.

RENDITJE E PIKËVE TOTALE

1. Operatori ekonomik “A.SH. Engineering” shpk me 100 pikë kualifikohet në vend të parë.
2. Operatori ekonomik “A & E ENGINEERING” shpk me 92.8 pikë kualifikohet në vend të dytë.
3. Operatori ekonomik “TESLA VIZION” shpk & “NET-GROUP” shpk me 90.04 pikë kualifikohet në vend të tretë.

Nuk ka operatorë te skualifikuar.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Operatorin ekonomik “A.SH. Engineering” shpk se oferta e paraqitur nga ana juaj dhe e vlerësuar me 100 pikë, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë *Autoritetit Përgjegjës, Bashkia Tiranë*, sigurimin e kontratës prej 15% të vlerës së saj, siç parashikohet në Aktin Normativ Nr.9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, Neni 43, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes së këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë: 03/11/2023

Ankesa: Në fazën e parë të procedurës së prokurimit nuk ka pasur ankesa.